AKTIVITETET 2025

Bashkia Lushnjë, në strukturën e saj organizative, ka të përfshirë Njësinë për Hartimin e Projekteve dhe Integrimin Europian, e cila ka një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave europiane, rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe informimin mbi procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Gjatë vitit 2025, përveç angazhimit në identifikimin e mundësive për financim, hartimin dhe ndjekjen e projekteve, Njësia ka zhvilluar një sërë aktivitetesh informuese, ndërgjegjësuese dhe edukative, me fokus kryesisht të rinjtë, fëmijët, komunitetin dhe grupe të ndryshme shoqërore.Aktivitetet e organizuara kanë synuar të përcjellin te qytetarët informacion mbi Bashkimin Europian, historikun dhe procesin e integrimit europian të Shqipërisë, të drejtat e qytetarëve, vlerat dhe parimet europiane, si dhe rëndësinë e demokracisë, barazisë, gjithëpërfshirjes, solidaritetit dhe mbrojtjes së mjedisit. Nëpërmjet takimeve me të rinjtë dhe nxënësit e shkollave, diskutimeve tematike, aktiviteteve ndërgjegjësuese, fushatave sensibilizuese dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore e organizatat e shoqërisë civile, Njësia ka synuar të nxisë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën e komunitetit dhe të afrojë më shumë qytetarët me konceptin dhe standardet e Bashkimit Europian.Një vëmendje e veçantë i është kushtuar shënimit të ditëve ndërkombëtare dhe europiane, duke i shfrytëzuar ato si mundësi për të trajtuar çështje me rëndësi sociale, kulturore, mjedisore dhe qytetare, si dhe për të promovuar edukimin, tolerancën, barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Për të garantuar transparencën dhe për të informuar publikun mbi veprimtarinë e saj, Njësia ka publikuar aktivitetet e zhvilluara, njoftimet, materialet informuese dhe rezultatet e tyre në kanalet zyrtare të komunikimit, përfshirë:

- Platformën “Bashkitë për në Europë”.

- Facebook: Njësia Integrimit Europian – Bashkia Lushnjë.

- Instagram: Njësia Integrimit Evropian.

Nëpërmjet këtyre kanaleve, qytetarët kanë mundësi të njihen me aktivitetet e realizuara, të informohen mbi çështjet e integrimit europian dhe të bëhen pjesë e nismave të ndryshme të ndërmarra nga Bashkia Lushnjë.

Në tërësi, veprimtaria e Njësisë gjatë vitit 2025 ka kontribuar në forcimin e informimit dhe ndërgjegjësimit qytetar, promovimin e vlerave europiane në nivel vendor dhe rritjen e përfshirjes së komunitetit në proceset që lidhen me zhvillimin dhe integrimin europian.

21 Janar - Dita e Kongresit të Lushnjës* Në kuadër të ngjarjes historike, ku u vendosën themelet e shtetit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore, 🇪🇺Njësia Integrimit Europian🇪🇺 organizoi një aktivitet me nxënësit e shkollës **Vath Korreshi** për të mësuar më shumë rreth rëndësisë së Kongresit të Lushnjës dhe trashëgimisë që ai la për kombin shqiptar. 🇦🇱

Ky aktivitet u zhvillua pranë **Qendra Rinore Multifunksionale** dhe kishte per qellim te nderoj rëndësinë historike te Kongresit të Lushnjes dhe ndihmoi te rinjte te angazhohen në krijimin e nje pemë kujtimesh me ngjarje te rendesishme qe lidhen me Kongresin e Lushnjes, citate te njohura nga figura te Kongresit ose mendimin e tyre per këte ngjarje per Shiperine.



📚**Dita Ndërkombëtare e Arsimit** - Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Arsimit, nxënësit e shkollës **9-vjecare " Liri Kazazi " Lushnje** morën pjesë në një aktivitet të veçantë, ku diskutuan dhe reflektuan mbi barrierat që vazhdojnë të ndikojnë në arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.

Nëpërmjet diskutimeve ata ndanë mendimet dhe idetë e tyre për Barrierat ekonomike, shoqërore dhe gjeografike dhe si ndikimin dhe mundësitë e arsimit në Shqipëri 🇦🇱. Ky aktivitet i ndihmon nxënësit të reflektojë mbi rëndësinë e arsimimit dhe të kuptojnë se përpjekjet për një arsim të barabartë janë të nevojshme për të mundësuar një të ardhme më të drejtë dhe të suksesshme për të gjithë.



🌳**Dita e Edukimit të Mjedisit** – Mbjellim Pemë për një Të Ardhme më të Gjelbër!* Në Ditën e Edukimit të Mjedisit 🇪🇺Njësia Integrimit Europian 🇪🇺në bashkëpunim me sektorin e Mjedisit në Bashkinë Lushnje zhvilloi një aktivitet të bukur dhe të dobishëm për mjedisin, duke mbjellë pemë për të kontribuar në ruajtjen e natyrës dhe pasurimin e hapësirave tona të gjelbra. 🌱

Ky aktivitet jo vetëm që na mësonë rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe pasurimin e mjedisit tonë, por gjithashtu shërbenë si një mundësi për të reflektuar mbi ndikimin që kemi mbi planetin dhe për të bërë ndryshime pozitive që ndikojnë në të ardhmen tonë. 🌍



Dita e Edukimit të Mjedisit 🌿 Sot, në kuadër të Ditës së Edukimit të Mjedisit, nxënësit e shkollës **9-vjecare"Skender Libohova"Lushnje** morën pjesë në një aktivitet të veçantë, duke mësuar për krasiten e pemëve në ambientet e shkollës, për t'i ndihmuar ato të rriten më të shëndetshme dhe për të kontribuar në ruajtjen e natyrës. 🌳

Ky aktivitet na kujtoi se kujdesi dhe mbrojtja e pemëve është një hap i vogël, por shumë i rëndësishëm, për të ruajtur ekosistemet dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës sonë. 🌱

Nxënësit mësuar rreth rëndësisë së bimëve dhe kujdesit ndaj tyre, kontribuan në pasurimin e mjedisit dhe ndihmuan në përmirësimin e ajrit dhe ambientit të shkollës. Kjo është një hap përpara në krijimin e një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të pastër!




"Kujtojmë dhe Mësojmë - Sot, në kujtim të **Ditës së Holokaustit**, nxënësit e shkollës **9-vjecare"Skender Libohova"Lushnje** morën pjesë në një aktivitet të oranizuar nga 🇪🇺Njësia Integrimit Europian🇪🇺 për të kujtuar dhe mësuar nga historia. Nëpërmjet leximeve, diskutimeve dhe intervistat e të mbijetuarve, ata eksploruan rëndësinë e kujtimit të viktimave dhe mësimet që mund të nxjerrim nga kjo tragjedi e errët e njerëzimit.

Holokausti nuk është thjesht një kapitull i historisë, por një kujtesë e gjallë që na kujton rëndësinë e tolerancës, respektit dhe luftës kundër urrejtjes dhe diskriminimit.



Sot, në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt**, me nxënësit e shkollës "**4 Deshmoret**" 🇪🇺Njësia Integrimit Europian 🇪🇺 në Bashkinë Lushnje zhvilloi aktivitet edukativ që i ndihmoi të kuptojnë rëndësinë e përdorimit të sigurt të internetit! 🚀

Ky aktivitet ka për qëllim jo vetëm t'u jep njohuri mbi sigurinë online, por gjithashtu t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi për të përdorur internetin në mënyrë pozitive dhe të sigurt dhe orarin e kufizuar që mund të përdorin gjatë ditës pajisjet teknologjike








🌍**Dita Ndërkombëtare e Drejtësisë Sociale** ⚖️ Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Drejtësisë Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkibë Lushnje, me nxënësit e klasës IX të shkollës “Skënder Libohova” u angazhuan në një aktivitet edukativ që synonte të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e barazisë dhe mundësive të barabarta për të gjithë! 🌱

Ky aktivitet është një mundësi që nxënësit të kuptojnë se çdo individ meriton të ketë mundësinë për të jetuar një jetë të plotë dhe të drejtë dhe rëndësisë e trajtimit të barabartë për çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, origjina apo pasuria



21 Shkurt -Dita Ndërkombetare e Gjuhës Amtare Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare Njësia e Integrimit Europian në Bashkinë Lushnje organizoi një aktivitet me fëmijët e ciklit parashkollor ne kopësht.

Për të ruajtur traditën dhe kulturën nëpërmjet përdorimit të gjuhës amtare angazhuam fëmijët të flisnin e të shkruanin që nga fjalët më të thjeshta e deri në recitimin e poezive në gjuhën shqipe.



Sot, festojmë forcën, guximin dhe shpresën që gratë dhe vajzat e botës i sjellin çdo ditë. Ju jeni burim i paepur i dashurisë, punës dhe sakrificës.

🌟Le të jemi të gjithë së bashku dhe të mbështesim njëri-tjetrin për të krijuar një botë ku çdo grua dhe vajzë mund të arrijë maksimumin e mundësive të saj.




💧**Dita Botërore e Ujit - Aktivitet me Nxënësit e Klasës 9** 🌍

Në kuadër të Ditës Botërore të Ujit, me nxënësit e klasës 7 🇪🇺Njësia Integrimit Europian së bashku me Sektonin e Mjedisit në Bashkinë Lushnje organizuan një aktivitet edukativ, ku u theksua tema e këtij viti: "Ruajtja e Akullnajave"❄️

Gjatë aktivitetit, nxënësit mësuan për rëndësinë e akullnajave në ruajtjen e ujit dhe ndikimin e ngrohjes globale mbi këto burime të çmuara. Ata diskutuan se si shkrirja e akullnajave ka pasojë drejtpërdrejt në nivelin e ujit të deteve dhe lumenjve, duke kërcënuar ekosistemet dhe jetën e njeriut. 🌿

Aktiviteti ishte një mundësi për t'i edukuar të rinjtë mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuimin në ruajtjen e burimeve natyrore, për një të ardhme më të qëndrueshme.



🌍**22 Prill – Dita Botërore e Tokës** 🌱**Tema: "Fuqia Jonë, Planeti Ynë"**

Në kuadër të kësaj dite me rëndësi për mjedisin dhe të ardhmen tonë të përbashkët, nxënësit e klasës së 8-të të shkollës “Foto Puka” morën pjesë në një aktivitet informues të zhvilluar në bashkëpunim me *AREB Lushnje*.

Agronomi i kësaj agjencie ndau me nxënësit njohuri të vlefshme mbi përdorimin e *metodave miqësore me mjedisin në bujqësi*, duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë e ruajtjes së tokës, ujit dhe natyrës që na rrethon.

🌿Edukimi për mjedisin nis që në bankat e shkollës – dhe sot, nxënësit tanë hodhën një hap të rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të gjelbër e të qëndrueshme!



Fëmijët e Kopshtit Nr. 2 festuan këtë ditë të veçantë duke mbjellë lule në oborrin e kopshtit dhe duke ngjyrosur me ngjyra plot jetë e dashuri për natyrën! 🌸🎨

Me duart e tyre të vogla dhe zemrat plot gëzim, ata dhuruan një mesazh të bukur: "**Të duam, Tokë!**"



9 Maj – 'Dita e Europës'

Njësia Integrimit Europian - Bashkia Lushnje 🇪🇺në Bashkinë Lushnje në bashkëpunim me shkollën "Lek Prevezi" në Plug organizuan një aktivitet të larmishëm dedikuar kulturës europiane.

Me këngë, kërcime dhe recitime në gjuhë të ndryshme të vendeve të Europës, nxënësit festuan vlerat e bashkimit dhe diversitetit, simbole BE!

Po ashtu u zhvillua një konkurs mbi njohuritë për Bashkimin Europian, ku fëmijët treguan njohuri dhe angazhim për të mësuar më shumë mbi këtë komunitet të madh ku synojmë të bëjmë pjesë shumë shpejt!



15 ***Shtator*** – ***Dita Ndërkombëtare e Demokracisë*** Sot, së bashku me stafin e Bashkisë Lushnje, zhvilluam një aktivitet të veçantë ku ndamë mendime dhe reflektime mbi rëndësinë e demokracisë në jetën tonë të përditshme.

💬Diskutuam mbi mënyrat se si vendimmarrja e përbashkët, bashkëpunimi dhe respekti për njëri-tjetrin forcojnë harmoninë në institucionin tonë dhe përmbushjen e përgjegjësive ndaj qytetarëve.

Demokracia nuk është vetëm një fjalë – është praktika jonë e përditshme, është dëgjim, mirëkuptim dhe bashkëpunim për të ardhmen e përbashkët.



Sot në kuadër të **Javës Europiane të Lëvizshmërisë** zhvilluam aktivitet me nxënësit e ciklit fillor të shkollës "**Skënder Libohova",** në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Fëmijët patën mundësinë të njihen nga afër me sinjalistikën rrugore si dhe rregullat bazë të qarkullimit. 🚦👮

Ky aktivitet synon të ndërgjegjësojë brezat e vegjël për sigurinë rrugore, kujdesin në lëvizje dhe ndërtimin e një kulture qytetare që fillon që në moshë të hershme.



♻**Dita Botërore e Pastrimit**

Sot iu bashkuam nismës mbarëbotërore për një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Bashkë me stafin e Njësisë nr 1 dhe 3 , sektori i mjedisit dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike si dhe qytetarë vullnetarë pastruam disa zona të qytetit, duke dhënë shembullin që ndryshimi fillon nga vetja. 🌱

Le të kujdesemi çdo ditë për hapësirat tona të përbashkëta, sepse një qytet i pastër është një qytet më i bukur dhe më mikpritës për të gjithë.



🌍🚴**Dita Ndërkombëtare pa Makina** 🚴🌍

Sot, fëmijët e kopshtit nr. 1/4 u bashkuan me një shëtitje të bukur me biçikleta në sheshin e qytetit, duke përcjellë mesazhin se një ditë pa makina është një ditë më e pastër, më e qetë dhe më e shëndetshme për të gjithë. 🌱✨

Energjia, buzëqeshjet dhe gjallëria e tyre na kujtojnë se e ardhmja është në duart tona dhe se ndryshimi nis me hapa (dhe pedale) të vogla. 🚲💚



📚Në kuadër të **Ditës Evropiane të Gjuhëve**, nxënësit e klasës së XII-të, nën kujdesin e mësueses Esmeralda Likja në shkollën e mesme "18 Tetor", realizuan një video kreative me ndihmën e inteligjencës artificiale.

📽️✨Ky aktivitet jo vetëm që përforcon rëndësinë e gjuhëve dhe kulturave europiane, por edhe tregon sesi teknologjia moderne mund të shërbejë si mjet për të nxitur mësimin dhe krijimtarinë.



🏫Shkolla e mesme “18 Tetori” u angazhua në shënimin e **Ditës Europiane të Gjuhëve.**


✨Nxënës dhe mësues të gjuhëve të huaja së bashku, sollën mesazhe të bukura dhe domethënëse në gjuhët e huaja që mësohen në shkollë, duke treguar se gjuha është ura që lidh kulturat dhe njerëzit.

🎉Atmosferë festive, kreativitet dhe dashuri për gjuhët u bashkuan në këtë ditë të veçantë, duke dhënë një mesazh të qartë: Gjuhët na afronjë dhe pasurojnë!



🌍**Dita Europiane e Gjuhëve** u shënua me një aktivitet të veçantë në shkollën e mesme “18 Tetori”, ku Njësia e Integrimit në bashkëpunim me mësueset e gjuhëve të huaja, organizuan një program informues dhe kuize në gjuhët që zhvillohen në shkollë.

🎉Nxënësit patën mundësinë të testojnë njohuritë e tyre, të argëtohen dhe njëkohësisht të mësojnë më shumë për kulturat dhe gjuhët që na afrojnë me Europën.





Në kuadër të **Ditës Europiane të Gjuhëve**, shkolla “18 Tetori” krenohet me krijimtarinë e një prej nxënëseve të saj Alesia Hajdari , nxënëse e klasës XI-3, e cila realizoi një website të veçantë kushtuar Europës dhe diversitetit gjuhësor 🌍✨.


💻Në këtë faqe janë përfshirë:🎶Këngë në gjuhë të ndryshme europiane🗺️Harta interaktive ℹ️Informacione interesante për çdo shtet të kontinentit

Ky krijim inovativ është shembull frymëzues se si pasioni për gjuhët dhe teknologjinë mund të ndërthuren për të sjellë një vlerë të re për shokët e klasës dhe më gjerë.










Dita Ndërkombëtare e Turizmit

Sot festojmë bukurinë dhe pasurinë që ofron qyteti ynë, Lushnja! 🏞️

Nëpërmjet këtyre videove sjellim disa prej vendeve turistike që e bëjnë qytetin tonë të veçantë – histori, kulturë dhe natyrë që presin të zbulohen. 🌿

Turizmi është një urë lidhëse mes njerëzve, traditave dhe zhvillimit, ndaj le ta promovojmë e ruajmë së bashku trashëgiminë tonë.



Në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve**, fëmijët dhe të moshuarit u bashkuan sot në lulishten e qytetit për të mbjellë një pemë, si simbol i dashurisë, kujdesit dhe vazhdimësisë së brezave. 🌱💚

Ky gjest i thjeshtë por i madh në domethënie na kujton se jeta është një zinxhir i bukur, ku çdo brez ka rrënjët dhe degët e tij që ushqejnë të ardhmen. 🌍

Të rinjtë dhe të moshuarit, së bashku, mbollën jo vetëm një pemë, por edhe shpresë, respekt e kujtime që do të qëndrojnë gjatë.



🇪🇺Njësia Integrimit Europian në bashkëpunim me Biblioteka Lushnje 📚sollëm sot fëmijët e kopshtin Nr. 1/4 në një udhëtim magjik mes përrallave dhe gjëagjëzave. 🦋✨

Të vegjlit dëgjuan me kureshtje tregime plot fantazi, mësuan fjalë të reja dhe zbuluan sa bukur është bota e librave. 📖📚

Le të vazhdojmë të kultivojmë dashurinë për leximin që në moshë të vogël!



Dita e Gjuhës Rome Sot, fëmijët e kopshtit u njohën më afër me kulturën dhe gjuhën e komunitetit Rom.

Me shumë dashuri dhe ngjyra, ata ngjyrosën flamurin e komunitetit Rom, duke mësuar për kuptimin dhe simbolikën e tij. 💙💚

Nëpërmjet aktiviteteve të tilla, mësojmë fëmijët të respektojnë dhe vlerësojnë larminë kulturore që na bashkon të gjithëve.

